



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE  
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA  
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD



Albania Water Regulatory Entity  
Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

## **MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM**

ndërmjet:

**Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM)  
Të Kosovës**

dhe

**Entit Rregullator të Ujit (ERRU)  
të Shqipërisë**

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) i Republikës së Shqipërisë dhe Zyra Rregullatore e Ujit dhe Mbeturinave (ZRRUM) e Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtutjeshëm “Palët”),

Duke dëshiruar ta promovojnë interesin e ndërsjellë përmes bashkëpunimit në fushën e rregullimit ekonomik të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe ujërave të zeza,

Duke e konsideruar nënshkrimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim si një kornizë për zhvillimin e relacioneve të bashkëpunimit afatgjatë dhe shkëmbimit të informacioneve mbi baza të barazisë, reciprocitetit dhe përfitimeve të ndërsjella,

Janë marë vesh si vijon:

### **Shkëmbimi i Informacioneve**

Palët do të shkëmbejnë informacione relevante që janë me interes të ndërsjellë si: politikat rregullatore që nuk janë konfidenciale; monitorimi i performancës dhe hartimi i raporteve të performancës; metodologjia e përcaktimit të tarifave dhe planet e menaxhimit të aseteve; dhe informacione operative relevante, sic janë procedurat e brendshme të organizative dhe administrative, e të ngjajshme, me qëllim që të mundësohet që personeli i dy institucioneve të mësojë nga përvojat e njëri tjetrit.

Shkëmbimi i informacioneve do të bëhet duke respektuar në tërësi ligjet dhe rregulloret e aplikueshme nacionale të dy vendeve.

## **2. Shkëmbimi i Njohurive**

Palët do të punojnë në ngritjen e njohurive të tyre lidhur me qasjen e njëra tjetrës sa i përket çështjeve të ndryshme rregullatore me qëllim që të sigurohet cilësia në zbatimin e rregullativës ekonomike të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Kjo do të bëhet në formën e shkëmbimit të përvojave dhe praktikave që zbatojnë palët gjatë punës së tyre.

## **3. Ngritja e Kapaciteteve – Zhvillimi i Stafit**

Kurdo që është e përshtatshme dhe e mundshme, Palët do të mbështesin stafin e tyre për:

- Pjesëmarrje në aktivitete dhe projekte specifike që organizon Pala tjetër;
- Pjesëmarrje në aktivitete trajnuese të Palës tjetër;
- Pjesëmarrje në konferenca, workshope apo seminare që mund të organizojnë Palët bashkarisht ose ndarazi.

## **4. Bashkëpunimi**

Kurdo që është e mundshme dhe e përshtatshme, Palët do të bashkëpunojnë në sigurimin e kualitetit të funksionimit institucional dhe të procesit rregullator. Po ashtu Palët do të bashkëpunojnë edhe në kuadër të oraganizatave dhe shoqatave rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e rregullimit ekonomik të sektorit të ujërave.

Bashkëpunimi do të përfshijë takime të rregullta të përfaqësuesve të Palëve të cilat do të mbahen së paku 1 herë në vit.

## **5. Personat Përgjegjës për Implementim**

Drejtori i ZRRUM dhe Kryetari i Komisionit të ERRU do të jenë persona përgjegjës për implementimin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit. Kjo përgjegjësi mund të delegohet tek anëtarët përkatës të stafit të tyre respektiv për fushat e veçanta të bashkëpunimit.

## **6. Resurset**

Normalisht, të dy Palët do të mbulojnë shpenzimet e tyre në lidhje me bashkëpunimin sipas kësaj Marrëveshje, përveq nëse dakordohet ndryshe me kontratë specifike. Kurdo që është e mundur dhe e përshtatshme, do të ofrohet mikpritja nga Pala nikoqire ndërkaq shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen nga vet Pala vizituese. Për fusha specifike të bashkëpunimit mund të eksploroohen mundësitë e kërkimit të fondeve nga donatorët.


## 7. Implementimi

Çfarëdo çështje apo kontesti që mund të del nga interpretimi dhe implementimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit do të zgjidhet nëpërmjet konsultimit dhe negociimit ndërmjet Palëve ose përmes mjeteve tjera sipas dakordimit të Palëve.

## 8. Hyrja në Fuqi

Ky Memorandum i Bashkëpunimit do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët dhe do të mbetet në fuqi për një afat pesë vjeçare. Pas këtij afati, Marrëveshja për Bashkëpunim do të jetë automatikisht valide për një afat tjetër pesë vjeçar, përveç nëse nuk ndërpritet më herët nga cilado prej Palëve me njoftimin me shkrim tre muaj para skadimit të afatit fillestar të vlefshmërisë.

**Nënshkruar në Prishtinë, nga Palët:**



**Zt. Avni Dervishi**  
**Kryetar i Komisionit të ERRU**

Datë: 15 prill 2009



**Zt. Afrim Lajçi**  
**Drejtor i ZRRUM**

Datë: 15 prill 2009